



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2622, datë 08.10.2015

Për

Shqyrtimin e kërkesës së sipërmarrësit Plus Communication sh.a. për revokimin e Vendimit Nr. 2614, datë 10.09.2015 për "Anullimin e Vendimit Nr. 2570, datë 22.05.2015" dhe ridërgimin e propozimit të rishikuar për MIAP për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin IMT".

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 08.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e kërkesës së Plus Communication sh.a. për revokimin e Vendimit Nr. 2614, datë 10.09.2015 për "Anullimin e Vendimit Nr. 2570, date 22.05.2015" dhe ridërgimin e propozimit të rishikuar për MIAP për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin IMT".

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë".
2. Nenet 5, 68, 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
3. VKM Nr. 635, datë 15.7.2015 "Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të

tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.

4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Vendimi i KD të AKEP Nr. 2614, datë 10.09.2015 për “Anullimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2570, datë 22.05.2015, për “*Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz brezi – IMT” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre”*”.

Shkresat e ardhura nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike:

2. Shkresa Nr. 2480/1 Prot., datë 24.06.2015 (prot. i AKEP Nr. 644/9, datë 09.07.2015) e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), “Përgjigje për shkresën tuaj me nr. 644/8 Prot., datë 25.05.2015 dhe shkresës nr.1114/2 të datës 18.6.2015”,
3. Shkresa nr. 2480/2, datë 24.07.2015 (prot. i AKEP Nr. 644/10 datë 27.07.2015) e MIAP, “Mbi ndryshimet e miratuara në VKM-në Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” të ndryshuar, dhe shkresën Tuaj Nr.644/8, datë 25.5.2016 mbi propozimin për kufizimin e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1900-1980 MHz, brezi IMT””, dhe
4. Shkresa nr. 3859/1 Prot., datë 08.09.2015 (prot. i AKEP nr. 644/7, datë 08.09.2015) e MIAP, “Përgjigje shkresës tuaj nr.644/13 të datës 24.08.2015 dhe tuajes me nr.644/8, datë 25.05.2015 mbi propozimin për kufizimin e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1900-1980 MHz, brezi IMT”.
5. Shkresa e Plus Communication sh.a (Plus), nr.1583Prot. datë 23.09.2015 (prot. i AKEP nr. 644/23 date 23.09.2015): Kërkohet revokimi i Vendimit Nr.2614 te AKEP, datë 10.09.2015 Për "Anullimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2570, date 22.05.2015" dhe ridërgimi i menjëhershëm i propozimit te rishikuar për MIAP per vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim te frekuencave në brezin IMT .
6. Relacioni përkatës;
7. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
8. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. AKEP me Vendimin nr. 2614, datë 10.09.2015 ka anuluar Vendimin nr. 2570, datë 22.05.2015, për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz brezi – IMT” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre””.

Ky vendim, ka plotësisht të argumentuar bazën ligjore të tij dhe vecanërisht është mbështetur në kërkesat/udhëzimet e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të përcjella me:

- Shkresën nr. 2480/2Prot, datë 24.07.2015, njofton AKEP se “...ndryshimet e miratuara në VKM-në nr. 1252, datë 10.9.2008, **çojnë në nevojën e konsultimit të elementëve të shtuar me palët e interesuara në procesin e propozuar nga ana e AKEP dhe, për rrjedhojë pezullimin e procesit aktual**”, si dhe me
- Shkresën nr. 3859/1 Prot., datë 08.09.2015 MIAP i njoftoi AKEP-it, se nuk miratoi propozimin e paraqitur me shkresën nr. 644/8, datë 25.05.2015, pasi nuk i përfshin të gjithë elementet e parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi, dhe se mbetet në pritje të risjelljes së propozimit bazuar në kuadrin ligjor në fuqi në një kohë sa më të shkurtër.

2. Plus, në kërkesën e tij përcjellë me shkresën nr.1583 datë 23.09.2015 pretendon se Vendimi i AKEP nr. 2614 dhe për rrjedhojë shtyrja në kohë e fillimit të procedurës për dhënien e Autorizimit 3G, është një vendim në shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në lidhje me përmbushjen e objektivave rregullatore dhe detyrimeve të AKEP.

Ky pretendim i Plus nuk qëndron, pasi Vendimi i AKEP nr. 2614, datë 10.09.2015, siç e argumentuam edhe më lart ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në aktet nënligjore të ndodhura në mes të një procesi i cili kishte nisur.

Gjithashtu, ky vendim është marrë duke patur parasysh edhe kërkesën/udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, për **nevojën e konsultimit të elementëve të shtuar (ligjorë) me palët e interesuara në procesin e propozuar nga ana jonë dhe pezullimin e procesit aktual** (shkresa nr. 2480/2 prot., datë 24.07.2015).

3. Plus pretendon se, kërkesa e Ministrit nr. 2480/2 Prot. datë 24.07.2015, drejtuar AKEP për risjellje në një kohë sa më të shkurtër të propozimit të rishikuar është tërësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe detyrimin ligjor të organeve rregullatore për të mbrojtur dhe siguruar konkurrencën efektive në treg dhe përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që të justifikojë mosjelljen e propozimit të ri nga AKEP.

Ky propozim, shprehet Plus, duhet vetëm të plotësohet me detajimin e procedurës së kryerjes së pagesave, dhe nuk ka përse të kalojë për këshillim publik.

AKEP shpjegon se, ky pretendim nuk qëndron pasi kërkesa e Ministrit sipas shkresës nr. 2480/2 Prot. datë 24.07.2015, drejtuar AKEP, nuk bën fjalë për risjellje në një kohë sa më të shkurtër të propozimit të rishikuar, siç pretendon

Plus në kërkesën e tij, por për “...nevojën e konsultimit të elementëve të shtuar (ligjorë) me palët e interesuara në procesin e propozuar nga ana jonë dhe, për rrjedhojë pezullimin e procesit aktual...” Eshtë pikërisht kjo kërkesë që është marrë në konsideratë nga AKEP si një nga argumentat për anulimin e vendimit nr. 2570, datë 22.05.2015.

4. Plus pretendon se, përgjigja negative e AKEP-it ndaj kësaj kërkesë, me pretendimin se, risjellja e propozimit, në kushtet e reja kur ka hyrë në fuqi VKM nr. 635, datë 15.7.2015, është përtej kompetencave ligjore që i janë dhënë AKEP-it, është thjesht një interpretim i pabazë për të justifikuar mosveprimin e AKEP dhe shtyrjen e pafund të kësaj procedure, në kundërshtim me interesin e përdoruesve dhe zhvillimin e konkurrencës në treg.

Anullimi i procedurës së iniciuar nga AKEP me vendimin nr. 2614, në vijim të mospranimit të pabazë të kërkesës së Ministres të Korrikut 2015, sjell shtyrjen e tejzgjatuar në kohë të marrjes së Autorizimit 3G për Plus në një afat jo më të shpejtë së tremujori i parë i vitit 2016.

5. Në përfundim, Plus, i kërkon AKEP-it, në mënyrë të menjëhershme:
- Revokimin e vendimit nr. 2416, datë 10.9.2015, si një vendim me pasoja tepër të dëmshme për tregun e telefonisë celulare dhe,
 - Dërgimin e menjëhershëm nga ana e AKEP të propozimit të rishikuar për Ministrin, për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin IMT, duke përfshirë elementët shtesë të kryerjes së pagesës me këste.

Pretendimet e Plus sa më lart, nuk qëndrojnë pasi AKEP, gjatë arsyetimit të bërë në vendimin nr. 2614, datë 10.09.2015, nuk është shprehur se, risjellja e propozimit, në kushtet e reja kur ka hyrë në fuqi VKM nr. 635, datë 17.7.2015, është përtej kompetencave ligjore që i janë dhënë AKEP-it, por ka theksuar se Ministri ka kërkuar/udhëzuar nevojën e konsultimit me palët. Dhe për këtë, ka vendosur pezullimin e procesit e mosmiratimit të propozimeve të AKEP.

AKEP sqaron se, në mbështetje të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, (nenet 5, 68) AKEP, si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike, në bashkëpunim me Ministrin e Inovacionit dhe Administratës Publike, si mbikqyrës i procesit, kanë marrë masat e nevojshme të kërkuara nga ligji dhe aktet nënligjore për zhvillimin e procedurës së dhënies së të drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin IMT.

AKEP, sqaron se, me ndryshimin e akteve nënligjore, konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” me Vendimin nr. 635, datë 15.7.2015, lind nevoja e një këshillimi publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi – IMT”.

AKEP, bazuar në përfundimet e arritura sa më lart, duke patur parasysh kërkesat dhe udhëzimet e dhëna nga Ministri, në korrespondencat e shkëmbyera mes palëve, në cilësinë e strukturave të ngarkuara nga ligji nr. 9918 dhe VKM nr. 1252, datë 10.9.2008 e ndryshuar, ka marrë vendimin e

anullimit të Vendimit nr. 2614, datë 10.9.2015.

Në përfundim, AKEP e konsideron kërkesën dhe pretendimet e sipërmarrësit Plus Communication sh.a. për revokimin e Vendimit nr. 2614, datë 10.09.2015, të pambështetura ligjërisht,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, dhe në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

V E N D O S:

1. Rrëzimin e kërkesës së Plus Communication sh.a. për revokimin e Vendimit nr. 2614, datë 10.09.2015, depozituar në AKEP me anë të shkresës me nr.1583Prot. datë 23.09.2015.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2614, datë 10.09.2015, për “Anullimin e Vendimit nr. 2570, datë 22.05.2015, për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz brezi – IMT” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre””.
3. Të njoftohet Plus Communication sh.a. për këtë Vendim;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____